



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1463 Prot.

Patos më, 15 / 05 / 2025



PROJEKT-VENDIM

Nr. 19, datë 15.05.2025

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT “RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS “SOTIR CAPO” DHE NDËRTIMI I PALESTRËS” DHE BASHKËFINANCIMIN NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 34 dhe 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, thirrjes për financimin e projekteve të reja me nr. 943/2 prot., datë 11/02/2025, kërkesës me nr. 709/3 prot., datë 05/03/2024 për financimin e projektit me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Sotir Çapo” dhe ndërtimi i palestrës”, shkresës nr. 2174/1 prot., datë 09/04/2025 në të cilën është konfirmuar miratimi i financimit të projektit të aplikuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ekipi i programit të menaxhimit në kuadër të miratimit të këtij projekti për financim, për të vazhduar me procedurat e mëtejshme,

KËRKON:

1. Të miratojë projektin objekt i investimit “Rikonstruksion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës” me vlerë projekti 192,664,044 lekë me financim për vitet 2025-2027.
2. Financimin e këtij projekti në masën 15% që do të mbulohet nga Bashkia Patos dhe 85% nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
3. Vlera e bashkëfinancimit prej 28,899,607 lekë, vlera 2,314,725 lekë që përfshin shërbimin e mbikqyrjes dhe kolaudit dhe vlera 203,542 lekë për kryerjen e shërbimit të oponencës teknike do të financohen përgjatë viteve 2025-2027 si më poshtë:
Vlera për vitin 2025 është 5,800,000 lekë dhe do të mbulohet brenda programit të Arsimit Bazë nga çlirimi i fondit për objektin “Rikonstruksion i kopështit me drekë, Patos”.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT
RRUGË RURALE
Drejtues i Programit
Ermenita **MICI**

Silvana MICI



ANËTARËT
Arlind RUSTO



Boreta MURATI



ARSIMI BAZË
Drejtues i Programit
Elda GOXHAI



ANËTARËT

Dorian SHPATA



Fatjona XOXI



Fatjon MICI



Lindita QALLIAJ

Juriste

Nurkë HAZIZAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS

Nr. 1463/Prot.

Patos më, 15/05/2025

RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT "RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS "SOTIR ÇAPO" DHE NDËRTIMI I PALESTRËS" DHE BASHKËFINANCIMIN NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Bashkia e Patos ka aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për financim të projektit "Rikonstruksion i shkollës "Sotir Çapo" dhe ndërtimi i palestrës", një projekt i cili do të ofrojë kushte më të mira për zhvillimin e procesit mësimor. Shkolla e mesme e bashkuar "Sotir Çapo" ndodhet në Njësinë Administrative Zharrëz dhe u shërben të gjithë nxënësve të njësisë pasi ajo frekuentohet nga 3 grupmosha të ndryshme, si parashkollor, ciklet e ulët dhe të mesëm. Prej vitesh në këtë shkollë nuk janë bërë ndërhyrje të mirëfillta për rikonstruksionin apo përmirësimin e kushteve për rreth 220 nxënës të cilët e frekuentojnë çdo ditë dhe përballen me mungesën e infrastrukturës bashkëkohore.

Godina në të cilën zhvillohet aktualisht mësimi është totalisht e amortizuar dhe ka nevojë për rikonstruksion total të ambienteve të brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu mungesa e ambienteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive është një problematikë tjetër, e cila kufizon zhvillimin normal të mësimdhënies për të gjithë grupmoshat. I gjithë objekti ka prani të lagështirës, dyer dritare të dëmtuara, shtresat e dyshemesë dhe mureve si pasojë e mungesës së ndërhyrjes prej vitesh janë degraduar duke u kthyer në një problematikë për të gjithë nxënësit dhe stafin e mësuesve, sidomos përgjatë ditëve me reshje të dendura shiu.

Ky projekt synon ndërhyrje në përmirësimin e kushteve të brendshme dhe të jashtme të objektit duke ofruar nxënësve ambiente totalisht të rikonstruktura duke filluar nga suvatimet, shtresa e pllakave, dyer, dritare të reja, ndriçim i plotë i klasave, sistem të ri ngrohje dhe furnizimi me ujë, si dhe me qëllim rritjen e sigurisë, sistem alarmi dhe mbrojtjes nga zjarri. Oborri i shkollës do të rikonceptohet duke u përshtatur për tre grupmoshat me ambiente çlodhëse dhe argëtuese si dhe do të shoqërohet me ndërtimin e një palestre me kushte bashkëkohore duke ofruar kushte për zhvillimin normal të lëndës së edukimit fizik apo dhe më tej. Do të krijohen hapësira të reja të munguara

aktualisht në shkollë si laboratore të fizikës, kimisë dhe informatikës. Po ashtu në çdo kat do të rikonstruktohen tualetet, të cilat ishin në gjendje shumë të rënduar. Në këtë mënyrë do të ketë një mësim cilësor për të gjitha klasat që ka aktualisht shkolla duke krijuar mundësinë dhe për klasa të tjera të cilët pritet të shtohen pas rikonstruksionit total të shkollës.

Fondi për rikonstruksionin e shkollës në masën 85% do të mbulohet nga Ministria e Arsimit dhe sportit me cikël financimi 2025-2027 dhe 15% nga bashkia Patos.

Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:


1. Të miratojë projektin objekt i investimit “Rikonstruksion i shkollës “Sotir Capo” dhe ndërtimi i palestrës” me vlerë projekti 192,664,044 lekë me financim për vitet 2025-2027.
2. Financimi i këtij projekti në masën 85% do të mbulohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe 15% nga Bashkia Patos.
3. Vlera e bashkëfinancimit prej 28,899,607 lekë, vlera 2,314,725 lekë që përfshin shërbimin e mbikqyrjes dhe kolaudit dhe vlera 203,542 lekë për kryerjen e shërbimit të oponencës teknike do të financohen përgjatë viteve 2025-2027 si më poshtë:
Vlera për vitin 2025 është 5,800,000 lekë dhe do të mbulohet brenda programit të Arsimit Bazë nga çlirimi i fondit për objektin “Rikonstruksion i kopështit me drekë, Patos”.
4. Për ndjekjen e zbatimin e projekt vendimit ngarkohet Drejtoria e Projekteve dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Shërbimeve.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

RRUGË RURALE

Drejtues i Programit

Ermenita MICI



ANËTARËT

Silvana MICI

Arlind RUSTO

Boreta MURATI



KRYETARI

Faton Duro

ARSIMI BAZË

Drejtues i Programit

Elda GOXHAJ



ANËTARËT

Dorian SHPATA

Fatjona XOXI

Fatjon MICI

Lindita QALLIAJ

